



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201501121/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

Lënda : *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe.*

Drejtuar : **Shefit të Komisariatit të Malësisë së Madhe  
Z. Shkelqim Kola**

**KOPLIK**

Për dijeni: **Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit  
Z. Haki ÇAKO**

**TIRANË**

***I nderuar Z.Kola,***

Institucioni i Avokatit të Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës<sup>1</sup>, më datë 01.06.2015, inspektoi Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, organ në varësi të Drejtorisë së Policisë Qarkut Shkodër.

Inspektimi u krye nga ekspertët e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës: Zj. Jorida Rustemi (psikologe, drejtuese e MKPT-së), Z. Alfred Koçobashi (jurist), Iris Laçi (juriste) dhe Zj. Alma Alibali, (mjeke psikiatre).

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

---

<sup>1</sup> Në mbështetje të nenit 19/1 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

## ***Shënime paraprake***

Inspektimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga njësia policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin, si dhe vlerësimit e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit sipas standardeve ligjore, nxjerrjen jashtë funksionit të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për procedurat e shoqërimit apo ndalim/arrestimit.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011 dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, fillimisht ekspertët morën kontakt me titullarin e këtij komisariati për t’i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se nga drejtuesi u tregua bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, vizitoi ambientet e shoqërimit/ ndalim/arrestimit dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

## ***Trajtimi i personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar***

Gjatë monitorimit nuk kishte persona të shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar. Personat e ndaluar/ arrestuar menjëherë pas veprimeve procedurale nga punonjësi i policisë, dërgoheshin në ambientet e Drejtorisë së Qarkut Shkodër. Nga këqyrja e librit të evidentimit të personave të shoqëruar/ të ndaluar/ arrestuar, nuk kishte mospërputhje mes kohës (orës) kur ishin ndaluar apo arrestuar me orën e shënuar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Gjatë vizitës së bërë në ambientet e komisariatit të policisë, u konstatua se në korridore, zyra të oficerëve të policisë gjyqësore ashtu dhe brenda dhomave të shoqërimit ishin afishuar të drejtat e personave. Në intervistë me punonjësit e policisë, ata pohuan se të ndaluarit/ arrestuarit njiheshin me të drejtat e tyre nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të

shoqërimit/ ndalimit/ arrestimit.

Gjatë vizitës u konstatua që në ambientet e shoqërimit dhe të hetimit nuk kishte aparat telefonik, me qëllim që të shoqëruarit, ndaluarit/ arrestuarit të komunikonin me familjarët e tyre<sup>2</sup>.

Në intervistë me punonjësit e policisë, grupi i punës u informua se të ndaluarit/ arrestuarit gëzonin aksesin për një avokat që në momentin e parë të privimit nga liria,<sup>3</sup> duke bërë të mundur që avokati të ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë, megjithatë u konstatua fakti që të ndaluarit/ arrestuarit, e kishin të pamundur për të bërë vetë zgjedhjen e mbrojtjes, pasi lista e avokatëve mbrojtës nuk ishte e afishuar.

Shërbimi psikologjik në këtë komisariat mundësohej nga psikologu i Drejtorisë Policie Qarkut Shkodër e cila thirrej për të ofruar ndihmën e saj në rastet e të miturve në konflikt me ligjin apo dhe rasteve të tjera ku konsiderohej e domosdoshme ndihma psikologjike.

Në Komisaratin e Policisë Malësi e Madhe u konstatua se, libri i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policie”, pasi ky regjistër ishte i një formati të vjetër dhe përdorej njëkohësisht si për regjistrimin e personave të shoqëruar, ashtu dhe për ato të ndaluar/ arrestuar. Në këtë rast nuk mund të plotësoheshin të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyrohen të dhëna për personat e shoqëruar, pasi instituti i shoqërimit ka të tjera specifika dhe kërkesa ligjore nga ai i të ndaluarve/arrestuarve.

Në këtë komisariat policie nuk kishte sistem monitorimi me kamera.

Në Komisaratin e Policisë Malësi e Madhe kishte një dhomë shoqërimi e cila ndodhet në katin e parë të ndërtesës së Komisarimit të Policisë. Dhoma ishte me dimensione 4 x 4m, me derë druri të veshur me llamarinë, mbyllja e të cilës bëhej me shul dhe me dry, me ndriçim nga rrjeti, e palyer por e pastër, me dritare e cila krijonte mundësi për ajrim e ndriçim të plotë natyral, por dhoma ishte pa ngrohje dhe nuk ishte e pajisur me orënditë e nevojshme si tavolinë, karrige apo stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Kjo dhomë kishte gjithashtu dhe një dritare të vogël në formë sporteli e cila komunikonte me një dhomë tjetër ngjitur, dhomë kjo e pamiratur si dhomë shoqërimi. Dhoma përdorej si për personat e shoqëruar madhorë meshkuj ashtu dhe për të shoqëruarit femra e të mitur, sipas rastit, duke mos përmbushur kërkesat e legjislacionit në fuqi që parashikon dhoma më vete.

Brenda korridorit ku ndodhej dhoma e personave të shoqëruar kishte një tualet, i cili ishte jashtë parametrave normal të funksionimit, pasi pajisjet ishin të dëmtuara.

---

<sup>2</sup> Kreu V, pika 6.1, germa “f” e Manualit

<sup>3</sup> Neni 53 i KPrP

Përdorimi i ambienteve të papërshtatshme është konstatuar edhe më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë inspektimeve të bëra. Për përmirësimin e kushteve të tyre i janë bërë disa rekomandime Drejtorisë së Policisë Qarkut Shkodër dhe Komisariateve të varësisë, por rekomandimet ndonëse janë mirëpritur në parim, nuk kanë gjetur zbatim praktik, pasi rezultonte se nuk ishte bërë asgjë konkrete për përmirësimin e tyre.

Me qëllim zgjidhjen e problemeve të mësipërme, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave për ndërtimin ose rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimin në Komisaratin e Policisë Malësi e Madhe në zbatim të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, Manualin e *“Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”* duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrjen e masave për pajisjen dhe plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar.
3. Marrjen e masave për vënien në përdorim, sa më parë të jetë e mundur, të librit të regjistrimit për personat e ndaluar/arrestuar.
4. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në këtë komisarjat.
5. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.
6. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

**Në mungesë dhe me Porosi**

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**